

REPUBLIKA E MAQEDONISË  
KOMUNA E LIKOVËS

Seksioni për Punë komunale, urbanizëm, ndërtimtari, mbrojtje të mjedisit jetësor dhe ZHEL

Në bazë të nenit 35, paragrafi 3 të Ligjit për planifikim hapësinor dhe urbanistik („Gz. zyrtare e RM-së,, nr.199/14, 44/15), nenit 50, pika 4 të Ligjit për vetëqeverisje lokale („Gz. zyrtare e RM-së,, nr.5199/2014, 44/2015, 157/2015, 193/2015, 31/2016, 90/2017, 64/2018, 168/2018), nenit 22 të Statutit të Komunës së Likovës dhe miratimit të Programit vjetor për punimin e planeve urbanistike të Komunës së Likovës për vitin 2019 me Vendim nr. 08-1305/13 dt 26.12.2018 nga Këshilli i Komunës së Likovës, Kryetari i Komunës së Likovës e jep këtë:

**L A J M Ë R I M**

**Për organizimin e prezentimit publik dhe anketës publike  
për Propozimine Kryetarit të Komunës së Likovës**

Kufijtë e përfshirjes janë: **Planit urbnaistik jashtë vendbanimit – PUJV për ndërtimin e kompleksit e objekteve me destinim B5-kompleks hotelerik në v.q. Baç dhe Bogovina, KK Bellanoc dhe KK Runicë, Komuna e Likovës**

Përfshirja është sipërfaqe prej 2,3 ha.

Anketa publike dhe prezentimi publik me propozim programin e Kryetarit të Komunës, do të zbatohet me ekspozimin e Propozim Planit në hapësirat e sallës të Këshillit të Komunës së Likovës.

**Anketa Publike do të zgjatë 10 ditë pune edhe ate prej 13.05-27.05.2019, çdo ditë pune nga ora 10,00 deri 15,00.**

Në afatin e përmendur, qytetarët e interesur dhe personat juridik nga rajoni konkret të përfshirë me planin mund të dorëzojnë vërtetje me shkrim, propozime dhe mendime në listat anketuese.

Prezentimi publik me prezentimin profesional të planit do të mbahet më dt.21.05.2019 në ora 10,30 në hapësirat e sallës së Këshillit të Komunës së Likovës.

Punoi, Ida Dije Arifi  
Kontrolloi, Feim Selmani  
Aprovoi, Nexhadi Osmani



Komuna e Likovës  
Kryetar,  
Erkan Arifi